

TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit		
Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00	
Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm		1

STANDARDET MINIMALE TË SHËNDETIT, SIGURISË & MJEDISIT PËR KONTRAKTUESIT

Datë	Lënda	Rishikim	Përgatitur	Kontrolluar	Miratuar
08/05/2020	Botimi i parë	0	Drejtore SHSM A. Romeo PICOHS D. Mataj	Drejtore Prokurimeve: F.E. Boffino Drejtore O&M: M. Liberale Drejtore Përgatitjes G.L. Cesarino	Drejtore Ekzekutive: A.Lleshi Drejtore Përgjithshme të Operimeve G.Peluso


TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	2

Tabela e përmbajtjes

1.	Parathënie	4
1.1.	Objekti	4
1.2.	Qëllimi.....	4
1.3.	Përkufizimet.....	4
2.	Standardet minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për kontraktuesit	5
2.1.	Shëndeti, Siguria & Mjedisi në përputhje me ligjin dhe kërkesat e AGSco-s dhe të Klientit	5
2.2.	Koordinimi i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit.....	5
2.2.1.	Takimet/mbledhjet e Koordinimit	6
2.2.2.	Dokumentet e koordinimit	6
2.3.	Organizimi i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit	7
2.3.1.	Treguesit kryesorë të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit dhe Raportimi mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin 8	
2.3.1.1.	Njoftimi dhe hetimi i incidenteve	8
2.3.2.	Vlerësimi dhe kontrolli i riskut.....	8
2.3.3.	Përgatitja në rast emergjence	9
2.3.3.1.	Personeli i emergjencës dhe ndihma mjekësore.....	9
2.3.4.	Menaxhimi i ndryshimit:.....	10
2.3.5.	Regjistri i Dokumenteve	10
2.4.	Standardet minimale në lidhje me personelin dhe procedurat	10
2.5.	Politikat e Drogave, Alkolit dhe Duhanit	11
2.5.1.	Kyerja e punës i vetëm	11
2.5.2.	Trajnimi, informimi, konsultimi dhe komunikimi	11
2.5.2.1.	Informimi, komunikimi dhe këshillimi	11
2.5.3.	Trajnimi dhe kompetencat	12
2.5.4.	Lejet dhe autorizimet e punës.....	13
2.5.5.	Inspektimi dhe auditet.....	14
2.5.6.	Siguria bazuar në sjellje	14
2.6.	Standardet minimale në lidhje me vendet e punës, Materialet dhe pajisjet.....	14
2.6.1.	Automjetet dhe impiantet lëvizëse	15
2.6.2.	Pajisjet mbrojtëse individuale (PMI)	16
2.6.3.	Hyrje dhe Dalje e Sigurt	17
2.6.4.	Puna e krahut me ngrkesa dhe Pajisjet Ngritëse.....	17
2.6.5.	Ndriçimi	18
2.6.6.	Pastertia (regulli) ne vendin e punes.....	18

TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	3

2.6.7.	Pajisjet dhe Veglat	18
2.6.8.	Instalimet e përkohshme elektrike.....	19
2.6.9.	Punimet e saldimit dhe prerjes	19
2.6.10.	Lëndë dhe materiale të rrezikshme.....	19
2.6.11.	Menaxhimi i mbetjeve.....	20
2.6.12.	Rrezatimi jonizues	20
2.6.13.	Zhurmat dhe Dridhjet	21
2.6.14.	Hapësirat e mbyllura dhe gërmimet.....	21
2.6.15.	Punimet në lartësi	21
2.6.16.	Impiant në punë/funksionim.....	22
2.6.17.	Municipionet	22
2.6.18.	Kërkesa të tjera specifike të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit.....	22
2.6.19.	Shërbimet Intelektuale	22

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	4

1. Parathënie

1.1. Objekti

Ky dokument zbatohet për të gjithë kontraktuesit dhe nënkontraktuesit e Albanian Gas Service Company me përjashtim të furnizuesve të mallrave dhe materialeve që nuk kanë nevojë të instalohen.

Për kontratën për marrjen me qira të ambienteve, ky dokument zbatohet vetëm për pjesën që lidhet me operacionet e mirëmbajtjes dhe punimet civile.

Për shërbimet intelektuale, zbatohet vetëm pjesa që lidhet me paragrafin 2.4.19.

Standardi është pjesë integruese e çdo procesi tenderues të AGSco-s, në lidhje me tipologjinë e lartpërmendur.

1.2. Qëllimi

Ky dokument përcakton një standard minimal të kërkesave për menaxhimin e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit që kërkohet nga Albanian Gas Service Company, për kryerjen e shërbimeve.

Dokumenti përbën një kërkesë kontraktuale midis Albanian Gas Service Company dhe kontraktuesve të saj, duke pasur parasysh respektimin e ligjit në fuqi, përmes kërkesave të një niveli më të lartë të performancës së Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit.

Përmbushja e këtij standardi duhet të konsiderohet si një kusht minimal në realizimin e veprimtarive që janë në objektin e Kontratës së vendosur ndërmjet AGSco dhe Kontraktuesve të saj.

Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet këtij Standardi dhe ndonjë ligji të aplikueshëm, ligji do të mbizotërojë.

1.3. Përkufizimet

Albanian Gas Service Company (AGSco): Ndërmarrja e Përbashkët midis Snam dhe Albga;

Masat parandaluese kolektive: zgjidhja teknike, organizimi i punës dhe procedurat që zvogëlojnë mundësinë e ndodhisë së një ngjarjeje të rrezikshme që mund të shkaktojë dëmtim për njerëzit, mjedisin, gjëra që ndodhin;

Masat mbrojtëse kolektive: zgjidhje teknike që zvogëlon nivelin e pasojave të një ngjarjeje të rrezikshme


Kontraktuesi: Një person ose firmë që ndërmerr një kontratë për të ofruar punë për kryerjen e një shërbimi, të bëjë një punë ose të ofrojë material ose mallra;

Detyra për tu kujdesur: në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, prodhuesit e mbetjeve kanë detyrën të sigurojnë që mbetjet menaxhohen siç duhet, riciklohen ose depozitohen në mënyrë të sigurt, nuk shkaktojnë dëm për shëndetin e njeriut ose ndotjen e mjedisit dhe transferohen vetëm tek dikush që është i autorizuar për të marrë mbetjet;

Rreziqet: çdo gjë që mund të shkaktojë dëmtim personal (dëmtim ose problem shëndetësor), mjedisor ose ndikim social të pafavorshëm të cilat, ndër të tjera, kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe negativ për reputacionin e AGSco ose të Klientëve të AGSco.

Identifikimi i rrezikut (IR): procesi i identifikimit të rrezikut.

Incidenti: Një ngjarje ose numër ngjarjesh të pakontrolluara ose të paplanifikuara, që ka/kanë shkaktuar lëndim, dëmtim fizik ose dëmtim të mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe sociale ose mospërputhje me standardet e dakordësuara. Ky përkufizim përfshin aksidentet, gati aksidentet dhe dukuri të rrezikshme sipas praktikave të industrisë;

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	5

Ekspozimi: numri i njerëzve të ekspozuar ose shkalla dhe ndjeshmëria e zonës së ndikuar;

Mundësia e ekspozimit: është mundësia që të ndodhë një ekspozim;

PMI: pajisjet mbrojtëse individuale;

Rreziku: përcaktohet si dëm i shumëzuar me mundësinë e dëmit që ndodh.

Vlerësimi i rrezikut (VR): procesi i vlerësimit të rrezikut.

Ashpërsia: shkalla e seriozitetit të lëndimit ose ndikimit në mjedis.

Operacionet e njëkohshme (SIMOPS): çdo situatë ku dy aktivitete të ndryshme ndodhin shume afër njëri tjetrit, se ekziston rreziku i ndërhyrjes, përplasjes ose transferimit të rrezikut.

2. Standardet minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për kontraktuesit

2.1. Shëndeti, Siguria & Mjedi në përputhje me ligjin dhe kërkesat e AGSco-s dhe të Klientit

Kontraktuesi do të sigurojë zbatim të plotë të ligjit, si dhe aplikimin e procedurave, udhëzimeve të punës dhe standardet e AGSco dhe Klientit, në mënyrë që të sigurojë performancën më të mirë të ShSM.

Kontraktuesi do t'i kërkojë të gjithë personelit të tij që të zbatojnë masat e sigurisë në përputhje me dispozitat e ligjit, të AGSco-s dhe të Klientit të AGSco. AGSco rezervon të drejtën të kërkojë nga Kontraktuesi largimin e përhershëm të punonjësve të cilët vendosin në rrezik shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit.


Gjatë fazës së tenderimit, Kontraktuesi do të sigurojë sa më poshtë vijon:

- pajtueshmëri të plotë me kërkesat përkatëse të legjislacionit shqiptar për shëndetin dhe sigurinë në vendet e punës, veçanërisht për sa më poshtë vijon:
 - Organizimi i punës;
 - Vlerësimi i riskut;
 - Masat specifike të kontrollit të rrezikut që janë miratuar;
 - Përshtatshmëria e personelit për kryerjen e punës;
 - Kontributet e sigurimeve shoqërore;
 - Regjistri i aksidenteve për tre vitet e fundit
- angazhim për të zbatuar dispozitat dhe parimet e AGSco-s dhe të Klientit, sipas kërkesave të përshkruara në këtë dokument;
- angazhim për përgatitjen e dokumenteve të koordinimit (Planet e Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, procesverbalet e mbledhjeve të koordinimit, planet e koordinimit), dokumentet operacionale të emergjencës, dokumentet operacionale sipas kërkesave të ligjit ose sipas kërkesës nga AGSco;
- përmbushje të kërkesave të menaxhimit të emergjencës, të parashikuara në legjislacionin shqiptar, si:
 - te kete procedura specifike për menaxhimin e emergjencave;
 - te kete një plani specifik emergjence;
 - emërim i personelit të trajnuar të emergjencës, mbrojtjes nga zjarri dhe personelit të ndihmës së parë dhe certifikatat përkatëse;

2.2. Koordinimi i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit

Kontraktuesi do të sigurojë se do të ushtrojë veprimtarinë në harmoni me masat e koordinimit të vendosura midis Klientit të AGSco-s dhe AGSco-s.

Kontraktuesi do të informojë menjëherë Menaxherin e Kontratës së AGSco-s për çdo ndryshim të rëndësishëm në kushtet operacionale, që kërkon një përditësim të masave të koordinimit.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	6

2.2.1. Takimet/mbledhjet e Koordinimit

Përpara datës së fillimit të kontratës do të organizohet një takim fillestar koordinues (KOM), midis AGSco-s, përfaqësuesve të Klientit dhe përfaqësuesve të Kontraktuesit, me qëllim diskutimin e kërkesave kontraktuale.

Kontrata e Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit / Plani i Koordinimit dhe masat e vendosura për të siguruar mbulimin e rreziqeve të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit do të përgatiten përpara fillimit të aktiviteteve. Të gjitha dokumentet e Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit do të aprovohen përpara fillimit të aktiviteteve.

Mbledhjet periodike të koordinimit mund të zhvillohen:

- me kërkesë të Klientit të AGSco-s dhe AGSco-s;
- kur kërkohet menaxhimi i SIMOPS;

Plani i Koordinimit i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit do të diskutohet në mënyrë që të integrohet përfundimisht.

Regjistrat e takimit të koordinimit do të përgatiten nga personeli i Kontraktuesit dhe do të ndahen me të gjitha palët e përfshira.

Vetëm procesverbali i mbledhjes i aprovuar nga AGSco do të konsiderohet i detyrueshëm.

2.2.2. Dokumentet e koordinimit

Për të gjitha aktivitetet që përfshihen në objektin e VKM 312/2010 dhe modifikimet dhe integrimet vijuese ose për aktivitete me rrezik të lartë (ku përfshihen punimet elektrike, punimet në lartësi, punimet në hapsira të mbyllura etj.), Kontraktuesi duhet të përgatisë një plan për koordinimin e kontratës për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin dhe duhet të aprovohet nga AGSco përpara fillimit të aktiviteteve.

Për aktivitete me rrezik të ulët, Kontraktuesi do të përgatisë dokumentet e koordinimit (Procesverbalet e mbledhjeve të koordinimit, planet e koordinimit), të cilat kërkohen sipas legjislacionit ose që do të kërkohen nga AGSco ose Klienti i AGSco-s.

Plani i koordinimit të Kontratës për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin është specifik për rreziqet dhe risqet që lidhen me objektin e punës dhe vendin e punës të Kontraktuesit (duke përfshirë nënkontraktuesit). Ky plan përcakton veprimet që duhen të ndërmerren për të kontrolluar rreziqet në një nivel të pranueshëm. Plani i koordinimit të kontratës për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin duhet të jetë në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës dhe standardet përkatëse të përcaktuara në këtë dokument.

Dokumenti do të nënshkruhet nga:


- Administratori përgjegjës si Përfaqësues i Punëdhënësit të Kontraktuesit;
- Personi përgjegjës për Shëndetin & Sigurinë në Punë të Kontraktuesit;
- Çdo person tjetër perkates brenda organizatës së Kontraktuesit;

Plani i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit mund të përfshijë një përkrahje të lidhjes midis kërkesave të Kompanisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit të Kontraktuesit .

Kontraktuesit kanë fleksibilitetin të ofrojnë plane të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit në një menyrë dhe format i cili është në përputhje me sistemet e tyre të menaxhimit dhe në çdo rast në përputhje me legjislacionin e vendit.

Plani i koordinimit të kontratës mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin do të përmbajë minimalisht sa më poshtë:

1. Organizimi dhe Përgjegjësitë mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin	<ul style="list-style-type: none"> • Përkrahja e organizimit dhe përgjegjësi të Kontraktuesit lidhur me Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, me fokus të veçantë për lidhjen me përdoruesit e tjerë të kantierit të punës.
2. Treguesit e Performancës të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> • Përkrahja e treguesve të performancës të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit i cili do t'i raportohet AGSco.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	7

3. Vlerësimi i Rrezikut dhe Riskut (duke përfshirë aspektet dhe ndikimet mjedisore)	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e rreziqeve dhe analiza e riskut në lidhje me objektin e punës. • Përshkrimi i metodologjisë së vlerësimit të riskut. • Metodatat e propozuara / aktuale të kontrollit të riskut. • Kriteret e pranimit të riskut.
4. Përgatitja dhe reagimi në rast emergjence	<ul style="list-style-type: none"> • Masat për të reaguar në mënyrë të arsyeshme ndaj emergjencave të parashikueshme (duke përfshirë incidentet mjedisore).
5. Menaxhimi i ndryshimit	<ul style="list-style-type: none"> • Masat për rivlerësimin e riskut, duke aprovuar (nga një autoritet i përshtatshëm) ndryshime në objektin e punës dhe duke aplikuar kontrole të përshtatshme të riskut, kur ndryshojnë parametrat operacional.
6. Dokumenti i Regjistrimit i Kryesor për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin	<ul style="list-style-type: none"> • Renditja e politikave, procedurave, udhëzimeve të punës dhe standardet e nevojshme të Kontraktuesit lidhur me Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, të nevojshme për zbatimin e standardeve dhe procedurave minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit të AGSco-s dhe për të përmbushur legjislacionin përkatës¹

¹ Mbetet përgjegjësi e Kontraktuesit të identifikojë dhe të sigurojë pajtueshmëri me të gjitha kërkesat ligjore të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, që lidhen punën / shërbimet e kontraktuara.

2.3. Organizimi i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit


Organizimi i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit duhet të përshkruhet në Planin Kontraktual të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, në termat e mëposhtëm:

- mënyra sesi Shëndeti, Siguria & Mjedisi është i integruar si një funksion i nivelit drejtues;
- masat për dhënien e këshillave mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin dhe mbështetje për nivelin drejtues;
- personat përgjegjës për zbatimin e kontrolleve të riskut, të përshkruara në vlerësimet e riskut;
- personat përgjegjës për raportimin e performancës së Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit tek AGSco;
- personat përgjegjës për të mbuluar rolet sipas Ligjit 10237 / 2010 dhe VKM 312/2020 dhe modifikimet dhe integrimi i tyre vijues, si për shembull por pa u kufizuar vetëm në:
 - Përfaqësuesi i punëdhënësit;
 - Personi përgjegjës për Shëndetin & Sigurinë në Punë;
 - Mjeku i Kompanisë;
 - Koordinatori i Sigurisë
 - Anëtarët e Këshillit të Shëndetit dhe Sigurisë;
- menaxhimi i nderlidhjes me përdoruesit e tjerë të kantierit të punës (p.sh. aktivitetet e njëkohshme me palët e tjera, përgjegjësitë e përbashkëta ose të deleguara me nënkontraktuesit).

Kontraktuesi do të identifikojë dhe emërojë zyrtarisht personat që do të jenë të pranishëm gjatë realizimit të punëve ose shërbimeve në kantier dhe të cilët do të jenë përgjegjës për të garantuar sa vijon:

- pajtueshmëri e plotë me dispozitat e ligjit;
- respektimin e dispozitave të AGSco-s dhe Klientit në lidhje me Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin;
- respektimin e dispozitave të koordinimit me aktivitetet e AGSco-s dhe Klientit.

Do të identifikohet mënyrë specifike Oficeri i emeruar për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, për të siguruar mbulimin e menaxhimit të riskut. Ky person siguron monitorimin e duhur të aktiviteteve në terren.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	8

Lista me emrin (emra) e personit (ave) të caktuar do t'i njoftohet AGSco-s përpara fillimit të aktiviteteve dhe në çdo rast jo pas takimit koordinues fillestar të aktiviteteve. Lista mund të përditësohet herë pas here, sipas nevojave operacionale.

2.3.1. Treguesit kryesorë të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit dhe Raportimi mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin

Kontraktuesi do të listojë në planin për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, treguesit specifik të performancës (KPI) për rreziqet dhe risqet që lidhen me objektin e punës dhe vendin (et) e punës të Kontraktuesit. Këta tregues duhet të jenë në përputhje ose të tejkalojnë kërkesat e raportimit të Kompanisë mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin.

Përpara fillimit të punimeve, treguesit kryesor të performancës që do të raportohen mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, do të dakordësohen me Departamentin për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin të AGSco-s, sipas adresave kryesore të cilat jepen nga Klienti i AGSco.

Për raportimin mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, kërkesat minimale kërkojnë përgatitjen e raporteve mujore për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin dhe njoftimin e menjëhershëm mbi incidentet e rënda.

Data e dorezimit për treguesit KPI të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit do të jetë e diela e fundit e çdo muaji. Kontraktuesi do të mbledhë të gjitha informacionet nga aktiviteti i tij, si dhe nga nënkontraktuesit dhe do t'i dërgojë tek departamenti i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit i AGSco-s, brenda afatit të percaktuar me siper. Kontraktuesi do të ketë fleksibilitetin për të përshtatur datën e dorezimit sipas ndryshimeve të kërkuara nga Klienti i AGSco-s.

2.3.1.1. Njoftimi dhe hetimi i incidenteve

Në rast të një incidenti në lidhje me punimet ose shërbimet sipas objektit të kontratës, kontraktuesi:

- përmbush të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me njoftimin autoriteteve publike;
- informon menjëherë AGSco-n, sipas afateve kohore dhe mjeteve të komunikimit që duhet të komunikohen, për të lejuar fillimin e procesit të njoftimit të Klientit të AGSco-s;
- aplikon kategorizimin e Klientit të AGSco-s, sipas procedurave që do të zbulohen pas nënshkrimit të Kontratës;
- kryen hetime që mund të kërkojnë sipas procedurave të AGSco-s dhe Klientit të AGSco-s.

2.3.2. Vlerësimi dhe kontrolli i riskut

Dokumenti i vlerësimit të riskut të përgjithshëm do të sigurohet midis dokumentacionit të tenderit, për të gjithë sipërmarrjen e Kontraktuesit, sipas Ligjit 10237 / 2010.


Gjithashtu, Plani i Kontratës të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, që do të sigurohet përpara fillimit të aktiviteteve, do të përmbajë një identifikim të rrezikut (HAZID) dhe një vlerësim të riskut (RA) për punime ose shërbime të përcaktuara brenda objektit të Kontratës, në përputhje me dispozitat e ligjit (Ligji 10237/2010 dhe VKM 312/2010 dhe ndonjë modifikim / integrim vijues).

HAZID dhe RA do të integrohen në Planin e Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, së bashku me masat e kontrollit të riskut.


Secilit faktor specifik i rrezikut do të menaxhohet, sipas:

- Dispozitave të ligjit;
- Praktikave të mira të industrisë;
- Dispozitave të AGSco-s / Klientit të AGSco-s përmes procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve operative që do të zbulohen pas nënshkrimit të kontratës;

Masat e kontrollit të rrezikut do të zbatohen në përputhje me hierarkinë e kontrolleve të riskut për të zvogëluar rrezikun në një nivel të pranueshëm ose të paktën në një nivel që **është i ulët sa të jetë praktikisht e arsyeshme (ALARP):**

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	9

1. **Eliminimi** i burimit të rrezikut kur është e mundur;
2. **Zëvendësimi** i burimit të rrezikut nëse është e mundur;
3. **Transferimi i rrezikut**, nëse është i zbatueshëm, i qëndrueshëm dhe aprovohet nga AGSco;
4. **Kontrollet inxhinierike**, për të izoluar njerëzit nga rreziqet përmes masave teknologjike
5. **Kontrollet administrative**, ndër të tjera dokumente të AGSco-s, trajnimet & aktivitetet ndërgjegjësuere, planifikimi dhe koordinimi, shenjat paralajmëruese
6. **Pajisjet mbrojtëse individuale**, që do të konsiderohen si mjete i fundit për qëllime të menaxhimit të riskut



AGSco-s do t'i jepen provat e identifikimit të rrezikut të lartpërmendur dhe vlerësimi i riskut. AGSco rezervon të drejtën, pasi kontrata të jetë në funksion, të kërkojë analizim të mëtejshëm, ndryshime ose integritime të mëtejshme tek vlerësimet, ku do të identifikohen mangësi serioze. Kontraktuesi duhet të plotësojë mangësitë e identifikuara.

2.3.3. Përgatitja në rast emergjence

Plani për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin përshkruan:

- Vendosjen e masave për të siguruar reagim të shpejtë në rast emergjence;
- Rrjedhën e komunikimit dhe piken e kontaktit dhe nderlidhjet perkatëse me AGSco;

Kontraktuesi, nëse kërkohet, do të sigurojë:

- Planin specifik për reagim në rast emergjence, në lidhje me objektin e punës së Kontraktuesit. Nëse punohet në një kantier pune të Kompanisë, Kontraktuesi do të integrojë masat e emergjencës me ato të AGSco-s dhe Klientit të saj dhe do të bashkëpunojë për koordinimin e menaxhimit të emergjencës me palët e tjera të përfshira.
- Prova të dokumenteve specifike të emergjencës për të trajtuar emergjencat të përgjithshme ;


Nëse ftohet, kontraktuesi do të marrë pjesë në ushtrimet që organizohen nga AGSco dhe Klienti i AGSco, në raste të situatave të emergjencës, duke vënë në dispozicion personelin dhe burimet eventuale midis atyre që janë në objektin e Kontratës.

2.3.3.1. Personeli i emergjencës dhe ndihma mjekësore

Përveç kërkesës shqiptare për përbërjen dhe kompetencat e ekipit të emergjencës, i gjithë personeli i përfshirë gjatë kryerjes së:

- aktiviteteve në kantierin e punës që i përket Klientit;
- aktiviteteve që përfshihen në objektin e aplikimit të VKM 312/2020;
- aktiviteteve me rrezik të lartë (punime elektrike, punime në lartësi, hapësira të kufizuara, etj.)

do të jetë:

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	10

- trajnuar si duhet, i çertifikuar nga një palë e tretë përkatëse dhe kompetente për të punuar në lidhje me:
 - mbrojtjen nga zjarri;
 - ofrimin e ndihmës së parë (edhe për incidentin elektrik);
 - masat për të reaguar në raste emergjente;
- pajisur me Pajisjet Mbrojtëse Individuale të përshtatshme për t'u përdorur gjatë situatave të parashikuara të emergjencës.

Personeli i emergjencës duhet të jetë i pajisur me një numër të përshtatshëm të kutive të ndihmës së parë, me materialet kryesoretë përshtatshme për lëndime të vogla;

Do të merren masa për evakuimin e sigurt të personave të sëmurë ose të dëmtuar, përtej kujdesit të Ndihmës së Parë, për tek një spital ose mjeku icaktuar.

Numrat e telefonit të emergjencës dhe procedurat përkatëse duhet të dokumentohen dhe të jenë të disponueshme në vendin e punës.

Për të gjitha aktivitetet që janë përjashtuar nga lista e mësipërme, përmbushja e kërkesës së ligjit shqiptar konsiderohet e mjaftueshme.

2.3.4. Menaxhimi i ndryshimit:

Për:

- aktivitetet në vendin e punës që i përkasin klientit;
- aktivitete që përfshihen në objektin e zbatimit të VKM 312/2020;
- aktivitete me risk të lartë (punimet elektrike, punimet në lartësi, ambiente të mbyllura, etj.)

Brenda Planit të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit / Planit të Koordinimit, Kontraktuesi përshtatshëm menaxhimin e procesit të ndryshimit (MoC). Në veçanti, Kontaktuesi do të përshtatshëm:

- mënyrën e menaxhimit të ndryshimeve operacionale
- metodat për rivlerësimin e rrezikut
- metodat për të siguruar që veprimet e kontrollit të rrezikut do të zbatohen
- procesin e autorizimit të ndryshimeve


2.3.5. Regjistri i Dokumenteve

Kontraktuesi lëshon një Regjistër të Dokumenteve (MDR) qoftë si një dokument i vecantë ose si listë referencash në Planin për Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin. Regjistri / Lista do të përmbajë dokumentacionin përkatës të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit të Kontraktuesit, në lidhje me objektin e punës.

2.4. Standardet minimale në lidhje me personelin dhe procedurat

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës ekskluzivisht për të gjithë personelin që kryen punën (përfshirë nënkontraktuesit e tij), dhe siguron që personeli i tij është:

- informuar për rreziqet që lidhen me aktivitetin;
- informuar dhe trajnuar për dispozitat e vendosura për kryerjen e shërbimeve;
- trajnuar si duhet mbi funksionimin e kontraktuesve dhe Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin;
- pajisur me pajisjet mbrojtëse individuale të mjaftueshme dhe është i informuar mbi mënyrën e përdorimit të tyre;
- pajisur me mjete të përshtatshme për të realizuar aktivitetet;
- i pajisur me raportin e aftësisë për punë;
- informuar për masat e evakuimit;

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	11

2.5. Politikat e Drogave, Alkoolit dhe Duhanit

AGSco aplikon një politikë tolerance zero ndaj konsumit të drogës dhe alkoolit në vendet e punës. Kompanitë kontraktuese do të kenë një Politikë me shkrim për Droget dhe Alkoolin, e cila përputhet ose tejkalon Polikën e AGSco-s, dhe që mbështetet në parimet e mëposhtme.

Kontraktuesi do të zbatojë një sistem testimi të bazuar në prova të arsyeshme. Ndër kriteret e tjera, sistemi i testimit do të zbatohet nëse punonjësi:

- dyshohet në mënyrë të arsyeshme se është dëmtuar gjatë punës për shkak të përdorimit të drogës ose alkoolit;
- është raportuar se ka të ngjarë të jetë nën efektin e alkoolit ose drogës, nga të paktën dy përfaqësues të AGSco-s ose përfaqësues të Klientit të AGSco-s, në vendin e punës;

AGSco rezervon, për vete dhe sipas kërkesave të Klientit, të drejtën për të kërkuar teste bazuar në të njëjtat kriteret.

Pirja e duhanit është rreptësisht e ndaluar në të gjitha zyrat, në të gjitha zonat e rrezikshme dhe në vendet ku mund të shkaktojë shqetësime për të tjerët, ndërsa pranohet në zona të caktuara.

Nëse ndonjë punonjës i Kontraktuesit:

- rezulton pozitiv ndaj testit të alkoolit;
- konstatohet se konsumon duhan në vendet ku është e ndaluar;

ai punonjës do të pezullohet menjëherë nga aktivitetet, në mënyrë që të mbrohet i dyshuari dhe koleget e tij.

AGSco:

- do t'i japë Kontraktuesit njoftim të menjëhershëm;
- rezervon të drejtën t'i kërkojë Kontraktuesit hetime të mëtejshme (si testim, intervistim, vizita mjekësore), brenda masës maksimale të limiteve të lejuar nga legjislacioni shqiptar, duke i kushtuar respektin e duhur privatësisë së personit.

Në çdo rast, çdo komunikim me punonjësit duhet të bëhet në mënyrë private. Nëse Punonjësi i cili është nën dyshim mbron të jetë nën efektin e substancave intoksikuese, mund të kërkojë që ai / ajo të ekzaminohet nga një mjek.

Testimi pas incidentit që përfshin lëndimin do të bëhet vetëm autoritetzyrtare të ose nga agjenci hetimi të incidenteve.

2.5.1. Kyerja e punës i vetëm

Në përgjithësi, puna e vetme është e ndaluar. Në rrethana të caktuara dhe


- pas një kërkesë me shkrim nga Kontraktuesi;
- bazuar në një vlerësim të riskut;
- përkufizimi i masës specifike për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë për punëtorin që punon i vetëm;

do të sigurohet me shkrim leje specifike

2.5.2. Trajnimi, informimi, konsultimi dhe komunikimi

2.5.2.1. Informimi, komunikimi dhe këshillimi

AGSco beson se komunikimi me të gjithë aktorët e interesuar është thelbësor për të siguruar ofrimin e sigurt dhe efikas të shërbimeve. Për këtë qëllim, Kontraktuesi do të sigurojë procesin e konsultimit dhe komunikimit të punëtorëve përmes, por pa u kufizuar në:

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	12

- "Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit në vendet e punës" që do të zhvillohet çdo tre muaj, sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar;
- Mbledhje periodike dhe "me qëllim" mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin;
- Materiale / mjete informuese siç janë komunikimet zyrtare dhe informale, posterat,
- broshura, njoftime në stenda afishimesh;

Sipas kërkesave të ligjit.

Për kontraktuesit që kryejnë:

- aktivitete në kantierin e punës që i përkasin klientit;
- aktivitete që përfshihen në objektin e aplikimit të VKM 312/2020;
- aktivitete me rrezik të lartë (punime elektrike, punime në lartësi, hapsira të mbyllura, etj.):
 - trajnimet fillestare të sigurisë në kantierin e punës, dokumentet e trajnimit, udhëzimet dhe të gjithë dokumentet lidhur me Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin do të jenë të përshtatshme për detyrat që duhet të kryhen dhe do të jenë në dispozicion në gjuhën e duhur të punonjësve.
 - Në mbledhje duhet të përfshihen në mënyrë ideale jo më shumë se 15 persona për të nxitur diskutimin e hapur.
 - Mbledhjet si "TBT " / "Vlerësimi Dinamik i Riskut" / përpara fillimit të punës do të zhvillohen në intervalet e duhura, në mënyrë që punonjësit të informohen për detyrat që duhet të kryhen, rolet dhe përgjegjësitë, risqet përkatëse dhe masat përkatëse të parandalimit. AGSco do të ofrojë modelin e TBT ;
 - Do merren masa që personeli të eliminojë rreziqet dhe të raportojë shqetësimet dhe ankesat mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin për mbikëqyrjen / menaxhimin e kantierit të punës. Një ankesë përcaktohet si ankim në bazë të lëndimit, dëmtimit ose vështirësive të pësuar. Inkurajohet përdorimi i simboleve dhe piktogrameve ndërkombëtare, kur nuk janë në kundërshtim me legjislacionin aktual.
 - Të gjitha dokumentet përkatëse të Kontraktuesit lidhur me Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin do të përgatiten në gjuhën angleze dhe shqipe (ose në gjuhën angleze dhe në gjuhën lokale të punonjësve) dhe do të përgatitet i gjithë dokumentacioni mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin, sikurse kërkohet nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë procedurat operative ndihmëse.
 - Komunikimi me komunitetet përreth do të adresohet përmes një qasjeje të bazuar në bashkëpunim. Në lidhje me këtë, çdo kritikë përkatëse, veçanërisht kritikata e mbledhura gjatë aktiviteteve në terren, do t'u komunikohet menjëherë përfaqësuesve të AGSco-s.

2.5.3. Trajnimi dhe kompetencat

AGSco beson se trajnimi dhe menaxhimi i kompetencave janë thelbësore për të siguruar menaxhimin e riskut.

Legjislacioni i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, në lidhje me kërkesat e trajnimit do të zbatohet në çdo kohë.


Trajnimi duhet të kryhet nga një personel i kualifikuar. Duhet të mbahen në dispozicion të dhënat e personave që morën pjesë në trajnim dhe përmbajtja e seancave të trajnimit.

Kontraktuesi është përgjegjës të sigurojë që vetëm personeli që është trajnuar më parë dhe siç duhet bazuar në vlerësimin e riskut do të përfshihet në aktivitetet brenda objektit të punës.

Kontraktuesit që kryejnë:

- aktivitete në kantierin e punës lidhur me klientin;
- aktivitete që përfshihen në objektin e aplikimit të VKM 312/2020;
- aktivitete me rrezik të lartë (punime elektrike, punime në lartësi, hapësira të kufizuara, etj.);

do të sigurojnë, përpara fillimit të veprimtarive, listën e personelit që do të përfshihet dhe provat e lidhura me trajnimin. Ndër të tjera sa kërkohet me ligj, Kontraktuesi do të sigurojë prova të dokumentuara të trajnimit /

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	13

informacion në lidhje me Planin e Kontratës / Planin e Koordinimit mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin. AGSco-s duhet t'i jepet çdo muaj kopje të trajnimit të detyrueshëm mujor ose trajnimeve të tjera të zhvilluara nga Kontraktuesi.

Çertifikatat duhet të përfshijnë detaje të identifikimit të personave pjesëmarrës në trajnime, detaje rreth programit të trajnimit dhe duhet të nënshkruhen nga një trajner i kualifikuar. Vetëm personeli i përfshirë në listën e mësipërme mund të përdoret për të kryer aktivitetet e punës. Lista e personelit mund të përditësohet, me kusht që Menaxherit të Kontratës t'i jepet njoftimi i duhur.

AGSco rezervon të drejtën të kërkojë nga Kontraktuesi çdo përditësim ose sqarim të mëtejshëm në lidhje me përmbajtjen e trajnimit ose informacione rreth trajnerit të kualifikuar.

Kontraktuesi do të trajnojë / ri-trajnojë personelin e tij::

- nëse janë zbatuar ndryshime të rëndësishme në organizim ose aktivitete;
- ndryshime të rëndësishme në mjetet, pajisjet, ligjin, standardet, substancat;
- nëse janë punësuar të rinj;
- kur një punëtor është i detyruar të kryejë një rotacion pune (me ndryshimet / profili i riskut);

Nëse për ndonjë veprimtari specifike kërkohet një certifikim specifik, patentë, licencë sipas ligjit, Kontraktuesi do të sigurojë prova që personeli është i trajnuar si duhet dhe është kompetent.

AGSco rezervon të drejtën të bëjë vlerësimin e kompetencës për personelin e Kontraktuesit dhe të kërkojë ri-trajnimin/ largimin e të gjithë personave të cilët konsiderohen se nuk janë kompetent.

Nëse AGSco ose Klienti i AGSco-s do të organizojë ndonjë aktivitet trajnimi, personeli i Kontraktuesit mund të ftohet të marrë pjesë dhe Kontraktuesi do të vërë në dispozicion personelin e tij për këtë qëllim.

2.5.4. Lejet dhe autorizimet e punës

Kontraktuesit që kryejnë:


- aktivitete në vendin e punës lidhur me klientin;
- aktivitete që përfshihen në fushën e aplikimit të VKM 312/2020;
- Aktivitete me rrezik të lartë (punime elektrike, punime në lartësi, hapësira të kufizuara, etj.);

duhet të pajisen me autorizim përpara se të kryejnë punën / aktivitetet.

Në veçanti, do të zbatohet sistemi "Leja për Pune(PTW)" i Klientit të AGSCO-s / AGSco-s, sipas vendit ku do të kryhen aktivitetet.

Sistemi "Leja për Punë" zbatohet për të gjitha aktivitetet që bien në objektin e Kontratës. Komisionimi, operimi dhe mirëmbajtja, aktivitetet e ndërtimeve të reja, modifikimi, duke përfshirë zgjerimin e aseteve të ekzekutuara në vendet e aseteve të Klientit, përfshihen në fushën e aplikimit të sistemit "Leja për Punë". Aktivitetet e tjera të kontrolluara nga sistemi "Leja për Punë" siç janë izolimi, hyrja në ambiente të mbyllura dhe gërmimet, do të dokumentohen duke përdorur certifikata speciale në lidhje me "Lejen për Punë". Procedurat specifike të AGSco-s ose Klientit të lidhura me këto aktivitete gjithashtu duhet të zbatohen në lidhje me procedurën e "Lejes për Punë".

Procedura "Leja për Punë" përfshin një numër hapash midis personave kompetent që japin lejen për të bërë objekte pune specifike dhe të rëna dakord. Procedura adreson përgatitjen, përdorimin, menaxhimin, kontrollin e lejeve dhe certifikatat për secilin vendndodhje të aseteve. Secili dokument duhet të identifikohet (numërohet) në mënyrë unike dhe të gjurmohet duke përdorur një regjistër të kantierit.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	14

Aktivitetet të cilat kryhen sipas Procesit të Menaxhimit të Alarmit (ngjarjet dhe rastet e emergjencës) do të ndjekin parimet e këtij procesi, në përputhje me planin e reagimit në situata emergjente. Asnjë aktivitet nuk do të kryhet nga Ekipi i Reagimit, nëse niveli i tij i riskut nuk është i pranueshëm.

Në rast emergjence, përpara se pala që kryen punën largohet nga zona dhe shkon në pikën e grumbullimit, dhe nëse sigurisht është e sigurt për të vepruar në këtë mënyrë, personeli siguron që zona e punës të lihet në një gjendje të sigurt.

Kontraktuesi duhet të ketë udhëzime specifike të punës për aktivitetet e tij, që nuk janë të përfshira në udhëzimet e punës të AGSco-s ose klientit të AGSco-s. Udhëzimi i punës duhet të përmbajë të paktën:

- Sekuencën e aktiviteteve;
- Listën e personelit, mjeteve, pajisjeve dhe makinerive që do të përdoren
- Listën e rreziqeve specifike
- Vlerësimin e riskut për detyrën specifike
- Planin kohor të aktivitetit
- Listat e kontrollit

Masat e kontrollit për aktivitetet operacionale rutinë do të kenë një Udhëzim Pune, ku identifikohen detyrat, rreziqet, masat parandaluese, personeli i përfshirë, pajisjet dhe listat kontrolluese. Për çdo Udhëzim Pune, do të kërkohet një “Leje Pune”. Niveli i “Lejes së Punës” do të përcaktohet në bazë të rreziqeve të lidhura me detyrën ose zonën e rrezikshme ku puna do të kryhet.

Për aktivitetet që nuk janë rutinë (p.sh. mirëmbajtja korigjuese, komisionimi, etj.), duke pasur parasysh rëndësinë e tij të veçantë dhe / ose rreziqet e mëdha që lidhen, do të kërkohet një Udhëzim i Veçantë i Punës Operative (SOWI). Ky Udhëzim i Veçantë i Punës Operative do të miratohet nga personat e duhur të AGSco-s dhe të Klientit, të nënshkruar në nivelet e tij përkatëse dhe do t'i bashkëngjitet Lejes së Punës.

Kur aktiviteti përfshin udhëtimin, shumica e punimeve do të kenë një Plan të Menaxhimit të Udhëtimit, i cili do të menaxhohet bazuar në procedurën e Planifikimit të Menaxhimit të Udhëtimit të Klientit.

Personeli i kontraktuesit do të vlerësohet të kryejë aktivitete brenda sistemit “Leja për Punë”.

Informacioni i mjaftueshëm në lidhje me lejen dhe autorizimin e punës do t'i jepet Kontraktuesit përpara fillimit të aktiviteteve.

2.5.5. Inspektimi dhe auditet

AGSco rezervon të drejtën të auditoje dhe inspektojë, gjithashtu, me anë të palëve të treta, Kontraktuesin, në mënyrë që të kontrollojë aplikimin e Standardit të përcaktuar nga ky dokument.


Gjithashtu, për kontratat që përfshihen në objektin e VKM 312/2020, Kontraktuesi duhet të ketë në funksion programin e tij të auditimit dhe inspektimit për të siguruar përmbushjen e kërkesave të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit të përcaktuara me kontratë.

2.5.6 Siguria bazuar në sjellje

Kontraktuesi do të zbatojë Protokollin BBS të AGSco-s / Klientit të AGSco-s, që përdor formatet BBS si vizita të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, vizita të lidhshme të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, vëzhgimi i planifikuar, veprimi/ gjendja e pasigurt në mënyrë që të ndërhyjë ndaj kushteve të pasigurta dhe të shfaqë sjellje pozitive mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin.

2.6. Standardet minimale në lidhje me vendet e punës, Materialet dhe pajisjet

Për të minimizuar rrezikun e Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, makineritë, pajisjet dhe vendi i punës duhet të projektohen të sigurt dhe të mirëmbahen. Nëse futen makineri dhe pajisje të reja do të vlerësohet rreziku nga personeli i duhur.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	15

Kufizimet e hapësirës, ndjeshmëria mjedisore e vendndodhjes së vendit të punës, ndërhyrja nga aktivitetet e tjera të punës dhe rreziqet e përgjithshme të mjedisit të punës, duke përfshirë ndriçimin, temperaturën, zhurmën dhe dridhjet, do të konsiderohen në masat paraprake të përgjithshme të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit të cilat zbatohen në vendin e punës.

2.6.1. Automjetet dhe impiantet lëvizëse

Të gjitha impiantet e lëvizshme që do të përdoren gjatë aktiviteteve duhet të jenë të pajisur me të gjitha liçencat e aplikueshme, çertifikatat e testimi dhe mbulimin me sigurim, që kërkohen me ligj. Të gjithë shoferët e automjeteve dhe të impianteve të lëvizshme do të mbajnë një liçencë të vlefshme për drejtimin e automjetit ose impiantit të lëvizshëm. Të gjitha impiantet e lëvizshme dhe automjetet, përveç automjetet për rrugë normale, do të pajisen me sinjal paralajmërues në rast të levizjes mbrapa. Shoferët duhet të zbatojnë politikën e AGSco-s për drejtimin e automjetit dhe procedurën e planifikimit të menaxhimit të udhëtimit të Klientit.

Të gjitha dokumentet, manualet, licencat, çertifikatat përkatëse duhet t'i sigurohen AGSco-s përpara se automjetet dhe impiantet e lëvizshme të hyjnë në kantierin e punës. Automjetet dhe impiantet e lëvizshme do të hyjnë në vendin e punës vetëm pasi AGSco të marrë të gjitha sa u përmend më lart dhe vetëm pasi të bëhet një kontroll vizual përfundimtar nga personeli i AGSco-s.

Kamionët nuk duhet të përdoren për transportin e personelit.

Përdorimi i "automjeteve private" në zonat e vendeve të punës është i ndaluar.

Të gjithë automjetet duhet:

- të mirëmbahen dhe të jenë në gjendje të sigurt pune përmes mirëmbajtjes së rregullt të planifikuar dhe të dokumentuar (në përputhje me udhëzimet e prodhuesit) me të dhënat mbështetëse të mirëmbajtjes së automjeteve;
- të jenë të pajisur me dokumentet e kërkuara me ligj (sigurimin, pronësinë e makinave etj) për vendin; dhe
- të jenë të pajisur me IVMS ku regjistrohen km e bërë dhe IVMS do të përditësohet me geofencing (perimetër virtual për zonat gjeografike) të zonave me rrezik të lartë ose të rrezikshme.

Ky sistem gjurmues do të:


- veprojnë në rrjetet 3G, 4G dhe satelitore (iridium);
- importojë dhe përdorë kartat dhe skedarët specifikë të operacioneve nga sistemi GIS i Klientit (softuer ESRI);
- përfshijë "geofences / gjeohapësira", kur automjeti përdoret për qëllime biznesi dhe nuk është private, për të gjitha zonat e kufirit të shpejtësisë përgjatë rrugëve që do të përdoren rregullisht; dhe
- në bazë të ligjit në fuqi, sigurojë Klientit të dhëna në lidhje me shkeljet e rregullave të ngarjes (p.sh. drejtim automjeti në mënyrë të ashpër, shkelje të kufirit të shpejtësisë, mos përdorimi i rripit të sigurisë, moskryerje e pushimeve të shkurtra, etj.) mbi një bazë anonime duke përdorur kodet e identifikimit të shoferit (pa përdorur emrat e shoferëve).

Automjeti duhet të jetë:

- i përshtatshëm për udhëtimin, terrenin ku do të udhëtohet, si dhe për numrin e udhëtarëve që udhëtojnë;

Ngarkesat e automjeteve duhet të jenë:

- të siguruar siç duhet, dhe mjetet ose pajisjet e lirshme nuk duhet të transportohen brenda ndarjes së pasagjerit, por duhet të vendosen prapa një ndarëseje mbrojtëse ose të shtrihen poshtë.
- të mos tejkalojnë specifikimet e projektimit, kufizimet e peshës ose kufijtë ligjorë të automjetit, si në dokumentin e regjistrimit të automjetit;
- të mos dalin mbi anët e automjetit; dhe

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	16

- çdo ngarkesë, e cila shtrihet përtej pjesës së pasme të automjetit, duhet të shënohet me një flamur të kuq dhe një dritë të kuqe dhe të respektojë çdo dispozitë tjetër ligjore të zbatueshme.

Tërheqja e automjetit nga një automjet tjetër është përgjithësisht e ndaluar. Automjeti mund të tërhiqet nga një automjet tjetër vetëm në situata emergjente, për të liruar automjetin që ka ngecur në baltë ose material të ngjashëm. Në çdo rast, automjeti që tërhiqet nuk duhet të jetë më i rëndë se mjete që e tërheq.

Automjetet duhet të jenë të pajisur me sa më poshtë vijon:

- mbështetëse koke për pasagjerët në ndenjëset e përparmë dhe të pasmë;
- çanta ajrore (air bag) për shoferin dhe pasagjerin në ndenjëset e përparme;
- rripa sigurie me 3 pika të përshtatshëm për të gjithë pasagjerët;
- automjeti duhet të jetë i pajisur me një dritë të lartë të frenave të pasme;
- ABS - Sistemi i Frenimit Anti-blok (megjithatë kjo kërkesë mund të hiqet nëse shumica e drejtimit do të bëhet në rrugë të pa-asfaltuara pasi ABS mund të rrisë distancën e frenimit në zhavorr dhe sipërfaqe të lirshme); dhe
- mbrojtëse për pasagjerët në rast rrokullisje të automjetit;
- radiot ose mjetet e tjera të përshtatshme të komunikimit

Automjetet duhet të jenë të pajisur me pajisjet e mëposhtme të sigurisë:

- kuti e ndihmës së parë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- fikse zjarri;
- trekëndëshi i paralajmërimit të sigurisë;
- jelek reflektues / me shikueshmëri të lartë dhe elektrik dore /llambë me bateri;
- goma rezervë, kasetë, kabllot e nisjes dhe rezerva të tjera për të zgjidhur avari të vogla;
- litar tërheqjeje (i përshtatshëm për peshën e automjetit) & shufra tërheqëse; dhe
- ujë.

Këto kërkesa shtesë do të zbatohen për drejtimin e automjetit jashtë rrugës ose lëvizje në zona malore:

- automjetet duhet të jenë 4 x 4;
- automjetet duhet të kenë gomat e duhura, d.m.th për baltë, dëborë etj;
- mbrojtëse shtesë në rast rrotullimi të automjetit. Në këto raste, pajisja mbrojtëse në rast rrotullimi do të projektohet dhe instalohet nga specialistët, në përputhje me standardet e industrisë së naftës dhe gazit dhe duke respektuar kërkesat e prodhimit; dhe në vlerësimin e detajuar të riskut në Planin e Menaxhimit të Udhetimit do të konsiderohen shpatet e pjerrëta, kushtet atmosferike në dimër, etj.


Gjatë aktiviteteve të furnizimit me karburant dhe gjatë mirëmbajtjes së pajisjeve që përmbajnë vaj do të ndërmerren masat e duhura për parandalimin e ndotjes.

AGSco rezervon të drejtën (gjithashtu për Klientin e tij) të inspektojë automjetet dhe impiantin e lëvizshëm për të konfirmuar nëse janë të përshtatshëm për detyrën. Dokumentet e inspektimit të kontraktuesit dhe certifikatat e palëve të treta do të vihen në dispozicion të AGSco (ose Klientit), sipas kërkesës.

2.6.2. Pajisjet mbrojtëse individuale (PMI)

PMI duhet të konsiderohen si mënyra e fundit për tu zbatuar, kur konstatohet se nuk është e mundur që rreziku të eliminohet ose nuk është e mundur/e praktikueshme që rreziku të reduktohet më tej, me anë të masave kolektive. Në çdo rast, PMI do të jenë të përshtatshme për nivelin e rrezikut të aktiviteteve dhe Kontraktuesi do të sigurojë që personeli i tij është i trajnuar siç duhet për veshjen, përdorimin dhe mirëmbajtjen e PMI-ve.

Nëse ndonjë prej personelit të Kontraktuesit do të konstatohet se nuk ka veshur PMI ose në përgjithësi kryen veprime të pasigurta duke shkelur rregullat e sigurisë, Kontraktuesit do t'i kërkojë të pezullojë menjëherë

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	17

personin nga aktivitetet. AGSco do të rezervojë të drejtën të kërkojë nga kontraktuesi largimin e përhershëm të një punonjësi të tillë.

Sa më poshtë konsiderohen si kërkesa minimale për të hyrë në zona pune / operative:

- Helmeta e sigurisë
- Këpucë sigurie (Mbulesë metalike e gishtave dhe poshte kembes)
- Kominoshe / veshje me mëngë të gjata (rezistente ndaj zjarrit kur përdoret në zona të rrezikshme)
- Syze sigurie

Niveli drejtues i kontraktuesit është përgjegjës për identifikimin e rreziqeve specifike në vendin e punës dhe aplikimin e kërkesave shtesë të PMI, sipas rastit. Kjo mund të përfshijë:

- Doreza
- Veshje me rezistencë ndaj motit dhe shikueshmëri të lartë
- Veshje dhe doreza rezistente ndaj agjenteve kimike
- Mbrojtje speciale e syve (syze, mburojë e fytyrës)
- Mbrojtje të aparatit të frymëmarrjes
- Mbrojtje e aparatit të dëgjimit

Të gjitha PMI do të jenë në përputhje me standardet EN, do të jenë të përshtatshme për rrezikun që duhet të menaxhohet dhe të krahasueshme me ato të aplikuara nga AGSco dhe Klienti i tij.

Kontraktuesit do të bëjnë një parashikim të arsyeshëm për furnizimin e PMI-ve të përshtatshme për vizitorët në vendin e punës, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me marrëveshje alternative.

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për të gjithë personelin që kryen punën (përfshirë nënkontraktuesit e tij) dhe duhet të sigurojë që personeli i tij ka marrë PMI të përshtatshme, mban shënime për shpërndarjen e PMI-ve dhe se këto të fundit mirëmbahen si duhet, si dhe personeli është i informuar mbi përdorimin e tyre.

2.6.3. Hyrje dhe Dalje e Sigurt

Të gjitha vendet e punës duhet të kenë hyrje dhe dalje të sigurt. Numri i daljeve shtesë të emergjencës do të jetë i përshtatshëm për rreziqet dhe numrin e njerëzve në kantier. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet që daljet e emergjencës të mos kenë pengesa.


Akresi i përkohshëm, siç janë shkallët dhe platformat e përkohshme të punës (p.sh. skelat dhe strukturat) do të ndërtohen sipas standardeve ndërkombëtare të projektimit, ngarkimit dhe inspektimit.

Shkallët do të përdoren si vend pune vetëm për punë të lehta me kohëzgjatje të shkurtër, dhe vetëm me këto kufizime:

- vetëm një person duhet të lejohet në një shkallë në çdo kohë
- ngarkesat nuk duhet të transportohen në të njëjtën kohë kur kryhet ngjitja në shkallë
- duhet të shmanget mbivendosja dhe tejkalimi
- shkallët duhet të sigurohen, mundësisht në krye dhe në fund.
- shkallët ose mjetet e tjera të hyrjes duhet të përdoren, mirëmbahen dhe kontrollohen sipas udhëzimeve të prodhuesit

2.6.4. Puna e krahut me ngrkesa dhe Pajisjet Ngritëse

Kontraktuesi duhet të zbatojë masat për të lehtësuar rreziqet e lëndimit që mund të shkaktohet nga ngritja me krahe e materialeve dhe pajisjeve. Pajisjet mekanike ngritëse duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin e punës, të certifikuar për përdorim, të përdoren nga personeli kompetent dhe do të përdoren vetëm brenda kufijve të ngarkesës së caktuar të punës së sigurt.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	18

Të gjitha dokumentet, manualët, licencat, çertifikatat përkatëse duhet t'i jepen AGSco-s përpara se pajisjet ngritëse të hyjnë në kantierin e punës. Pajisjet ngritëse do të hyjnë në kantierin e punës vetëm pasi AGSco të ketë marrë të gjitha ato që u përmendëm më lart dhe vetëm pasi personeli i AGSco-s të ketë kryer një kontroll përfundimtar vizual.

Pajisjet ngritëse duhet të përdoren, mirëmbahen, kontrollohen sipas manualit të udhëzimeve të prodhuesit. Një listë e makinerive, pajisjeve dhe veglave ngritëse duhet të përditësohet dhe të jetë e disponueshme sipas kërkesës.

Për procesin e ngritjes nëpërmjet pajisjeve mekanike ngritëse, do të përgatitet plani specifik i ngritjes.

2.6.5. Ndryçimi

Ndryçimi i mirë është thelbësor për një vend të sigurt pune dhe i nevojshëm për kryerjen e punës. Kontraktuesit duhet të sigurojnë sa vijon:

- vlerësojnë kërkesat për ndryçim për pune të lokalizuara si dhe ndryçimin e përgjithshëm, por do të shmangin ndryshimet e tepërta në ndryçim
- ndryçimi i përgjithshëm duhet të jetë sa më i lartë të jetë e mundur mbi zonën e përgjithshme të punës
- pozicionojnë dritat e lokalizuara në mënyrë që të parandalohet shkëlqimi, verbimi ose reflektimi
- ndryçimi duhet të marrë parasysh përdorimin e PMI-ve - syze dhe format e tjera të mbrojtjes së syve mund të kufizojnë shikueshmerinë
- sigurojnë që ndryçimi nuk shton rrezikun e nxehtësisë ose burimeve të ndezjes - përdorin ndryçimin rezistent ndaj shpërthimit në zona të rrezikshme
- sigurojnë që ndotja nga ndryçimi të menaxhohet në vende me ndjeshmëri ndaj mjedisit.

2.6.6. Pastertia (regulli) në vendin e punës

Pastertia (rregulli) në vendin e punës është përgjegjësi e të gjithë personave në vendet e punës. Vendi i punës rregullohet përpara, gjatë dhe pas një aktiviteti, dhe kjo procedurë është e domosdoshme për të mbajtur një vend të sigurt, të pastër dhe të rregullt. Materialet e nevojshme për punë / shërbime duhet të ruhen dhe mbahen siç duhet jashtë rrugëve; duke lejuar hyrje dhe dalje të sigurte. Në fund të çdo dite pune, në zonat e punës nuk duhet të ketë skrap dhe materiale të panevojshme.


Kontraktuesi do të sigurojë që mbetjet dhe materialet e mbeturinave të minimizohen në burim sa më shpejtë që të jetë e mundur, të ruhen siç duhet dhe asgjësohen sipas rregullave lokale. Kontraktuesi do të sigurojë që të përdoren sisteme mbajtëse sekondare fikse ose të përkohshme (p.sh. argjinaturë, tabaka pikimi, etj.) për të mbajtur çdo material të rrezikshëm në vendin e punës, përfshirë materialin që mbahet në impiantin e lëvizshëm, siç janë gjeneratorët elektrikë.

2.6.7. Pajisjet dhe Veglat

Pajisjet dhe veglat përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë projektuar dhe vetëm nga një person i trajnuar dhe kompetent. Në përdorimin e pajisjeve dhe veglave, punonjësit tregojnë kujdes të arsyeshëm për sigurinë e tyre dhe për njerëzit, mjedisin dhe gjërat rreth tyre. Çdo vegël e rrezikshme që nuk mund të zëvendësohet në mënyrë korrekte dhe të rivendoset në funksionimin fillestar të sigurt duhet të hiqet dhe të depozitohet siç duhet, sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit.

Mjetet e tensionit të ulët duhet të përdoren aty ku është e mundur dhe vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet tokëzimit dhe transformimit të duhur të energjisë, shpërndarjes dhe kabllëve.

Mjetet elektrike do të testohen rregullisht, sipas udhëzimit të prodhuesit, i nënshtrohen një programi testimi të bazuar në riskun, i cili është i dokumentuar dhe i auditueshem.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	19

Listat e kontrollit dhe regjistrimet e inspektimit do t'i sigurohen AGSco-s / Klientit, sipas kërkesës.

2.6.8. Instalimet e përkohshme elektrike

Instalimet e përkohshme elektrike do të miratohen nga një organ i çertifikuar përpara se të përdoren. Vetëm komponentët që përputhen me rregulloret lokale do të përdoren dhe këto nuk do të përshtaten për t'u përdorur nga kushdo tjetër përveç një elektricisti të çertifikuar.

Vëmendje e veçantë i kushtohet:

- mbështjelljes së përshtatshme dhe forcimit të kablove
- tokëzimit të komponentëve
- klasifikimit të duhur EX për vendin e punës
- vendndodhjes së kablove - nëse rrugëtimi përgjatë tokës është i pashmangshëm, kabllo duhet të fiksohen dhe shënohen dhe mbrohen nga dëmtimet nga punimet / shërbimet që kryhen. Nëse kabllo janë pezull, ato duhet të jenë në një lartësi të përshtatshme për trafikun dhe materialet që lëvizin në kantierin e punës, ato duhet të mbështeten, jo nën tension në lidhje, dhe të shënohen qartë.
- Përdorimit të pajisjeve të duhura për zgjatjen e kablove

2.6.9. Punimet e saldimit dhe prerjes


Kontraktuesi duhet të zbatojë masat paraprake të përshtatshme kundër rreziqeve të punimeve të saldimit dhe prerjes

Rreziku dhe pasojat	Masat
Zjarre dhe shpërthimet (nga flakë e zhveshur / hark / sipërfaqe të nxehta, rrjedhje të lëndës djegëse / oksigjenit, materiale të ndezshme)	Kontrolli i rreptë i punës (përmes sistemit "Leje për Punë") në zonat me atmosfera të ndezshme dhe ene që përmbajnë lëngje dhe gaze. Përdorimi i "vëzhguesve të zjarrit". Kontrolli i rreptë i inspektimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të saldimit.
Dëmtimet nga djegia (nga metali i nxehtë, shpërndarja e saldimit, rrezatimi termik)	Përdorimi i PMI të përshtatshme siç janë veshjet dhe dorezat rezistente ndaj zjarrit.
Lëndimet e syrit (nga shkëlqimi, rrezatimi UV)	Përdorimi i syzeve të saldimit ose mbrojtësve për të gjithë fytyrën.
Sëmundje e aparatit të frymëmarrjes dhe helmimi (tymi dhe gazrat toksikë)	Ajrosja e mjedisit të punës dhe / ose përdorimi i pajisjeve mbrojtëse të frymëmarrjes.
Goditja elektrike (nga gjeneratorët elektrikë)	Kapësja lidhëse për kabllon e kthimit duhet të lidhet sa më afër të jetë e mundur me saldimit. Të gjithë kabllo dhe lidhësit duhet të jenë në gjendje të mirë dhe të izolohen siç duhet.
Rrëshqitje, pengesa dhe rënie (nga kryerja e punës në hapësira pune të kufizuara)	Hyrje dhe dalje e duhur. Platformat e duhura të përkohshme të punës duhet të instalohen siç duhet. Zona e punës duhet të ndriçohet mirë dhe të mirëmbahet.

2.6.10. Lëndë dhe materiale të rrezikshme

Në mënyrë të përgjithshme, Kontraktuesi siguron menaxhimin e duhur të çdo lëndë ose materiali që do të përdoret gjatë kryerjes së punimeve ose shërbimeve. Ndalohet përdorimi i lëndëve dhe materialeve të ndaluara me ligj. Nëse gjatë inspektimeve apo auditeve në kantierin e punës të AGSco-s konstatohen të disponueshme për përdorim materiale apo lëndë të ndaluara, AGSco rezervon të drejtën për të kryer çdo veprim për të mbrojtur interesat e tij, përfshirë edhe ndërprerjen e kontratës.

Në rastin e përdorimit të Lëndëve ose Materialeve të Rrezikshme gjatë kryerjes së punimeve ose shërbimeve, Kontraktuesi u jep punëtorëve informacionin e duhur. Në këtë drejtim, fletët me të dhënat e sigurisë së materialit (MSDS) të përgatitura nga prodhuesi, duhet të jenë gjithnjë në dispozicion të punëtorëve, për të siguruar informacionin e duhur mbi masat specifike parandaluese dhe mbrojtëse që duhet të zbatohen nga punëtorët, për të ruajtur shëndetin dhe sigurinë e njerëzve dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	20

Nëse një substancë ose një material nuk është i pajisur me MSDS, përdorimi i tij do të ndalohej.

Në çdo rast, Kontraktuesi:

- minimizon përdorimin e lëndëve kimike dhe materialeve të tjera të rrezikshme;
- vendos organizimin e duhur për menaxhimin e substancave të rrezikshme, duke caktuar një person përgjegjës;
- aplikon të gjitha mjetet teknologjike të nevojshme për të siguruar ambient të sigurt, bazuar në vlerësimin e riskut dhe matjet mjedisore;
- mban inventarë të lëndëve dhe materialeve të rrezikshme, duke specifikuar sasinë, llojin, tiparet dhe pajtueshmërinë ndërmjet agjentëve të ndryshëm;
- siguron largimin e sigurt të lëndëve dhe materialeve të përdorura.

2.6.11. Menaxhimi i mbetjeve

Kontraktuesi, sipas objektit të VKM 312/2010, do të komunikojë përpara fillimit të aktiviteteve dhe në çdo rast jo pas takimit fillestar koordinues, emrin e personit (ose personave) përgjegjës për zbatimin e një sistemi të administrimit të mbetjeve, bazuar në parimet e administrimit të mbetjeve, të listuar si më poshtë.

Në çdo rast, Kontraktuesit dhe ofruesit e AGSco-s:


- sigurojnë zbatimin e kërkesave ligjore për trajtimin, ruajtjen (sasinë, kontaminimin dhe periudhën e ruajtjes), asgjësimin e mbetjeve dhe kontrollin e ndotjes;
- marrin të gjitha masat e justifikueshme ekonomikisht dhe teknikisht për të minimizuar prodhimin e mbetjeve, duke zvogëluar humbjen e burimeve natyrore dhe materialeve dhe duke promovuar ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin;
- maksimizojnë efikasitetin e logjistikës gjatë transportimit të mbetjeve;
- sigurojnë se të gjitha mbetjet e gjeneruara llogariten, monitorohen dhe hidhen me përgjegjësi, sipas Detyrës për tu Kujdesur;
- te kene planin e duhur të emergjencave për trajtimin e incidenteve nga ndotja;
- sigurojnë monitorimin dhe menaxhimin e duhur të emetimeve;
- në rastin e nën-kontraktimit, sigurojnë që masat paraprake të ngjashme do të zbatohen nga Kontraktuesit e tij;
- zhvillojnë dhe zbatojnë një Plan të përshtatshëm për Menaxhimin e Mbetjeve

2.6.12. Rrezatimi jonizues

Përdorimi kryesor i pajisjeve që lëshojnë rrezatim jonizues në vendin e punës është në radiografi. Kontraktuesi do të ketë një sistem të administrimit për të siguruar që ekspozimi personal ndaj rrezatimit jonizues të minimizohet dhe në çdo kohë, të jetë nën kufijtë ligjorë.

Sistemi përfshin si më poshtë:

- përcaktimin e zonave të kontrolluara dhe distancat e duhura të ndarjes, të plotësuar me shenja paralajmëruese, të ketë ne funksion dokumentacionin e kërkuar dhe një sistem për përjashtimin e personelit të paautorizuar
- lejet për sistemet e punës, kontrollin e autorizimit dhe nderlidhjen me aktivitete të tjera
- këshilla dhe mbikëqyrje të specializuara, përfshirë një Mbikëqyrës të Çertifikuar të Mbrojtjes nga Rrezatimi
- kompetenca dhe trajnimi i personelit të punës
- magazinimin e duhur, transportin, trajtimin dhe monitorimin e burimeve radioaktive
- mbulimin e burimeve radioaktive
- monitorimin e personelit të ekspozuar (dozimetrat personal, regjistrimet, mbikëqyrja mjekësore)
- kufizimin e kohëzgjatjes së ekspozimit.

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	21

2.6.13. Zhurmat dhe Dridhjet

Do të merren në konsideratë zhurma e ambientit dhe nivelet e dridhjeve në vendin e punës, si dhe ato si rezultat i drejtpërdrejtë nga puna / shërbimet. Limitet statusore për ekspozimin e zhurmës (zakonisht të matur për një periudhë ekspozimi 8-orëshe) nuk duhet të tejkalohen. Për të kufizuar ekspozimin dhe / ose shqetësimin nga zhurma, duhet të zbatohen kontrollet e mëposhtme:

- ulje e zhurmës ose dridhjes në burim, p.sh. zgjedhja e pajisjeve me zhurmë të ulët, kur është e mundur
- izolimi dhe veçimi i zonës së punës nga burimi i zhurmës ose i dridhjeve, për shembull barrierat izoluese akustike
- kufizimi i periudhës së ekspozimit
- përdorimi i PMI për mbrojtjen e dëgjimit.

2.6.14. Hapësirat e mbyllura dhe gërmimet

Kontraktuesi do të sigurojë që janë marrë masa paraprake shtesë të sigurisë për punën / ofrimin e shërbimeve në zona veçanërisht të rrezikshme siç janë hapësirat e mbyllura dhe gërmimet. Kompania kërkon që Kontraktuesi të zbatojë një Sistemin Lejes per Pune në raste të tilla.

Për hyrjen në hapësirë të kufizuar, do të konsiderohen si më poshtë:

- A është hyrja e domosdoshme apo mund të bëhet puna nga distanca si një metodë më e sigurt?
- A janë praktike të gjitha izolimet (mekanike dhe elektrike)?
- Hyrjet dhe daljet do të bëhen sa më pak kufizuese të jetë e mundur
- Do të përcaktohen kushtet në hapësirën e mbyllur, p.sh. gaze toksike dhe / ose të ndezshme, atmosferë asfiksuese, si para hyrjes ashtu edhe kur puna vazhdon
- A është hapësira e mbyllur kufizuese për personelin që punon?
- A ka rreziqe shtesë siç janë ndryshimet në nivel, ndriçimi i dobët, komunikimi i dobët, sipërfaqet e nxehta / të ftohta, etj?

Për shërbime / punë që përfshijnë personelin që hyn në tubacion, Kompania kufizon hyrjen në tub në 50 metra. Kontraktuesi do të paraqesë një plan për mënyrën se si propozohet të sigurojë sigurinë e atyre që janë të përfshirë në hyrjen e tubit dhe plani do të miratohet nga Funkzioni i Cilësisë, Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit i Kompanisë.

Një plan i tillë duhet të përfshijë, minimumi:

- një sistem leje pune për "hyrje në hapësirë të kufizuar", ku identifikohen rreziqet (duke përfshirë rrezikun nga tymi / gazi, sipërfaqet e nxehta, qëndrueshmëria e tubit, hyrja e kufizuar);
- mënyra sesi do të mbrohet nga rreziqe të tilla personi që hyn;
- mënyra si jepet autorizimi për hyrje, mënyra si shërbimet / puna do të mbikëqyren nga jashtë
- masa që janë marrë për shpëtimin;
- mënyra se si do të mbrohet pjesa e brendshme e tubit nga dëmtimet.

Gjithashtu, duhet të përmbushen të gjitha rregulloret kombëtare.


Gërmimet më të thella se 1.5 (një pikë pesë) metra do të konsiderohen gjithashtu hapësira të mbyllura dhe mund të kërkojnë masa paraprake shtesë siç janë mbrojtja për të parandaluar shembjen, studimi i instalimeve nentokesore, kufizimet në gërmimet mekanike, etj. Gërmimet e ceketa mund të kërkojnë masa të tilla paraprake dhe kjo procedurë do të përcaktohet në fazën e vlerësimit të rrezikut.

2.6.15. Punimet në lartësi

Kontraktuesi do të sigurojë që janë marrë masa paraprake shtesë të sigurisë për punën / ofrimin e shërbimeve në zona veçanërisht të rrezikshme siç është puna në lartësi. Kompania kërkon që Kontraktuesi të zbatojë sistemin e Lejes për punë.

Puna në lartësi do të marrë në konsideratë si në vijim:

- zgjedhjen e llojit më të përshtatshëm të platformës së punës

	TITULLI:	Standardet Minimale të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit për Kontraktuesit	
	Numri i DOKUMENTIT:	AGSco - STD - 001	Rishikimi 00
	Klasifikimi:	Për përdorim të brendshëm	22

- dizajnin, ndërtimin dhe çertifikimin e platformës për ngarkesat e punës të përfshira (përfshirë ngarkesat e erës)
- mbrojtja e platformës nga ndikimi i automjeteve dhe ngarkesat e ngritura
- hyrje dhe dalje të sigurt
- masa për të parandaluar rrëzimin e objekteve, mjeteve, pajisjeve dhe materialeve
- mbrojtje personale individuale siç janë pajisjet për mbrojtje nga reniet, etj.

2.6.16. Impiant në punë/funksionim

Gjatë punës pranë impianteve të cilat janë në punë/funksionim duhet të ketë masa paraprake të duhura për të parandaluar shtrirjen e punës në zona të rrezikshme dhe duhet të merret parasysh kontrolli i veprimtarive të ngritjes mbi tubacione dhe mjete lundruese dhe shmangia e kontaktit me kabllot ajrore.

Gjatës kryerjes së punës në impiantet që janë në punë/funksionim duhet të ushtrohet kontroll përmes sistemit “Leje për Punë”. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet izolimeve elektrike dhe mekanike, mbikëqyrjes së duhur dhe autorizimit të kthimit në statusin normal të funksionimit.

2.6.17. Municionet

Puna ose sigurimi i shërbimeve (sipas rastit) në zonat me prani të njohur ose të dyshuar me municione (lëndë e pashpërthyer, mbetjet e luftës) kërkojnë procedura shumë specifike shëndetësore, sigurie dhe mjedisore për t'u trajtuar në Planin e Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit

Në çdo rast:

- aktivitetet do të ndalen menjëherë;
- njerëzit dhe pajisjet do të largohen;
- zona rrethohet;
- AGSco do të informohet menjëherë.

2.6.18. Kërkesa të tjera specifike të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit

Kjo kërkesë mund të jetë subjekt i përditësimeve për shkak të përditësimit të Procedurave të AGSco-s ose të Klientit. Në një rast të tillë, rishikimi i ri do t'i jepet Klientit dhe do të zbatohet.

Të gjitha kërkesat e tjera të detyrueshme sipas ligjit shqiptar.

Të gjitha kërkesat e tjera që nuk përfshihen shprehimisht në këtë dokument, por që ri-përfshihen brenda procedurave të AGSco dhe Klientit të AGSco.

Të gjitha liçencat, standardet, trajnimet dhe dokumentet që kërkohen nga një këshill lokal, rajon, shteti ku do të kryhet veprimtaria dhe që nuk përfshihen në listën e mëparshme, do të identifikohen dhe zbatohen.

Legjisllacioni / kërkesat e ndryshme që nuk janë në listën e mëparshme, por janë specifike të vendit të punës, do të përfshihen si të detyrueshme.

2.6.19. Shërbimet Intelektuale

Kontraktuesit që ofrojnë shërbime intelektuale do të trajnohen për Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin para se të hyjnë në çdo ambient të AGSco-s. Nëse aktivitetet do të kryhen në zonat që ekspozojnë Kontraktuesin në një nivel rreziku më të lartë se ai i zyrave të AGSco-s, do të jepet një trajnim specifik i dokumentuar.

Kontraktuesi do të zbatojë të gjitha përkrahjet që janë në fuqi në ambientet, impiantet, objektet e AGSco-s ose Klientëve të AGSco-s.